

Hapet thirrja për aplikime për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin West Attica, Greqi, për të marrë pjesë në aktivitetin “International Staff Week” që ata do të organizojnë në datat 05 – 09 Dhjetor 2022.

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin West Attica, Greqi, për pjesëmarrje në Javën e tyre të Trajnimit në datat 05 – 09 Dhjetor 2022, me temë “Innovative Management in Higher Education, Applied Practices in Covid-19 Pandemic and Remaining Challenges”.

<https://erasmus.uniwa.gr/en/homepage/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;

Kohëzgjatja:

- 5 + 2 ditë;

Bursat përfshijnë:

-Kompensim ditor (160 EUR për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë:

- CV + Lista e publikimeve (në gjuhën angleze / greke);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze / greke);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj;

- Vërtetim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, ku);

- Plani i mobilitetit për mësimdhënie;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies. Ky dokument firmoset nga aplikanti në momentin e aplikimit dhe më pas nga Koordinatori Institucional Erasmus+.

Afati për aplikim: **13 Tetor 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!